



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:182937
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05732418

CA.nr.5376/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Faton Ademi e Besnik Feka anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit-propozuesit M. Xh nga Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson P. P, avokat nga Prizreni, kundër të paditurve- kundërshtarëve të sigurimit I. I dhe N. I, të dy nga Komuna e Prizrenit, të cilët me autorizim i përfaqëson B. Sh, avokat nga Prizreni dhe R. Xh dhe N. Xh, të dy nga Komuna e Prizrenit, të cilët me autorizim i përfaqëson A. A, avokat nga Prizreni, për shkak të anulimit të kontratës, me propozim për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit-propozuesit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.2789/2023 të datës 27.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa e paditësit-propozuesit M. Xh nga Komuna e Prizrenit, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.2789/2023 i datës 27.03.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Historiku procedural:

Me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit aprovohet kundërshtimi i paraqitur nga kundërshtarët e masës së përkohshme të sigurimit I. I dhe

N. I, të dy nga Komuna e Prizrenit, dhe R. Xh dhe N. Xh, të dy nga Komuna e Prizrenit, si i bazuar. Në pikën II., të dispozitivit anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.2789/23, i datës 14.09.2023, me të cilin është caktuar masa e përkohshme e sigurimit. Në pikën III., të dispozitivit refuzohet si i pabazuar propozimi i paditësit-propozuesit M. Xh nga Komuna e Prizrenit, me të cilin ka kërkuar që të aprovohet propozimi i propozuesit ashtu që *“CAKTOHET MASA E SIGURISË, ndalohet qarkullimi në çfarëdo forme i pjesëve të ngastrës kadastrale numër 1877/1 në sipërfaqe të përgjithshme prej 7258 m², e evidentuar në emrin e të paditurve R. Xh dhe N. Xh, si pjesë e ngastrës së përmendur në emrin e R. Xh dhe atë pjesa prej 418/7258 si dhe në emrin e N. Xh pjesa prej 113/700 në të gjitha zyrat noteriale si dhe legalizimi i transaksioneve tjera eventuale te organet kompetente”*. Në pikën IV., të dispozitivit procedura në këtë çështje juridike-kontestimore do të vazhdohet sipas rregullave të procedurës kontestimore dhe sipas planit të punës së gjykatës.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur paditësi pa i cekur shkaqet, me propozim që të anulohet aktvendimi i atakuar në tërësi, dhe masa e përkohshme e sigurisë e lejuar më parë, të mbetet në fuqi.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, dhe pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, 208 dhe 209 të LPK -së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi-propozuesi M. Xh ka parashtruar propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, ndaj të paditurve-kundërshtarëve të sigurimit I. I, N. R. Xh dhe N. Xh, me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e sigurisë, të ndalohet qarkullimi në çfarëdo forme i pjesëve të ngastrës kadastrale numër 1877/1 në sipërfaqe të përgjithshme prej 7258 m², e evidentuar në emrin e të paditurve R. Xh dhe N. Xh, si pjesë e ngastrës së përmendur në emrin e R. Xh dhe atë pjesa prej 418/7258 si dhe në emrin e N. Xh pjesa prej 113/700 në të gjitha zyrat noteriale si dhe legalizimi i transaksioneve tjera eventuale te organet kompetente.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar me ankesë.

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK-së: “Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi, pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji”.

Neni 195.1 i LPK-së: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejtë para saj:d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur”.

Neni 209 par.1 i LPK-së: “Duke vendosur për ankimin e veçantë, gjykata e shkallës së dytë mund:b) të refuzoj ankesën si të pa themeltë dhe e vërteton aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë”.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të ligjshëm e miraton në tërësi kolegji i Gjykatës së Apelit, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore e për të cilat shkaqe gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare, dhe se në rastin konkret është bërë zbatimi i të drejtës materiale në mënyrë të drejtë. Në vendim janë dhënë arsye të mjaftueshme të cilat i pranon dhe kolegji i gjykatës së shkallës së dytë.

Kolegji miraton vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë se nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 297 të LPK-së, për caktimin e masës së sigurimit, për arsye se pala propozuese e sigurimit nuk e ka bërë të besueshëm ekzistimin e rrezikut real se pa caktimin e masës së propozuar, pala propozuese e sigurimit do të pësoj dëm të pa riparueshëm dhe se me këtë do të vështirësohej dukshëm realizimi i kërkesës. Në nenin 304.3 të LPK-së përveç tjerash është parashikuar që *propozuesi duhet ti tregoj edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesa e tij, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim, dhe që këto mjete provuese t’ia bashkëngjisë propozimit*. Kolegji gjen se pala propozuese e sigurimit nuk ka argumentuar se në çka konsiston ekzistimi i rrezikut dhe vetë dëmi i pa riparueshëm për propozuesin e sigurimit. Për më tepër, kolegji i Gjykatës së Apelit gjen se, gjykata e shkallës së parë pas daljes në vend së bashku me ekspertin gjeometër ka gjetur se nuk është vërtetuar arsyeshmëria

për caktimin e masës së sigurisë. Padiësi përmes propozimit ka kërkuar që të caktohet masa e sigurisë dhe të ndalohet qarkullimi në çfarëdo forme i pjesëve të ngastrës kadastrale numër 1877/1, në sipërfaqe të përgjithshme prej 7258 m², e evidentuar në emrin e të paditurve R. Xh dhe N. Xh, si pjesë e ngastrës së përmendur në emrin e R. Xh dhe atë pjesa prej 418/7258, si dhe në emrin e N. Xh pjesa prej 113/700. Gjykata e shkallës së parë pas analizimit dhe vlerësimit të ekspertizës së gjeodezisë të datës 13.02.2024, dhe dëgjimit të ekspertit në seancën dëgjimore, ka konstatuar se parcela me nr. 1877-1, është krijuar nga ndarja e parcelës amë 1877-0, e cila është regjistruar në elaboratet kadastrale, duke shtuar në elaboratin kadastral mungon kufiri i parcelës 1877-1, sipërfaqja e përgjithshme grafike e parcelës 1877-0, është 1 hektar e 10 ari e 82m², e që ngastra kadastrale e këtu palëve ndërgjyqëse është pronësi e përbashkët e shumë bashkëpronarëve, e njëjta nuk është e ndarë me kufijtë juridik.

Në nenin 319.1 të LPK-së është parashikuar që secila nga palët ndërgjyqës ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet e veta. Meqenëse, pala propozuese nuk ka bërë një gjë të tillë, kolegji ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet e palës propozuese të parashtruara në propozimin mbi masën e sigurimit, pretendimet ankimore i ka refuzuar si të pa bazuara dhe ka bërë vërtetimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) dhe 209 par.1 pika b) të LPK-së, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.5376/2024, me datë 23.05.2024

Kryetari i kolegjit - gjykatësi,
Dr.sc. Rafet Haxhaj